



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: + 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

Psh. nr. 809/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 104, 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej Vedat Poterqoi – Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "GEO PRIM" SHPK me seli në Tiranë, kundër njoftimit për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Instrumente GPS" me numër të prokurimit: 632-22-7865-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Kuvendi Komunal Gjakovë, më datën: 10 shkurt 2023, mori këtë:

VENDIM

- 1. Hedhet si e palejuar**, ankesa e OE "GEO PRIM" SHPK me seli në Tiranë, e datës 29.12.2022 (protokoll 809/22), e parashtruar kundër njoftimit për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Instrumente GPS" me numër të prokurimit: 632-22-7865-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Kuvendi Komunal Gjakovë.
- 2. I Lejohet**, autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal Gjakovë që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Instrumente GPS" me numër të prokurimit: 632-22-7865-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Kuvendi Komunal Gjakovë, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.
- 3. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik** ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale

Për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Instrumente GPS" me numër të prokurimit: 632-22-7865-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Kuvendi Komunal Gjakovë, 03.08.2022 kishte publikuar Njoftimin për kontratë. Me pas me datë 18.10.2022 kishte publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, po ashtu me datë 23.12.2022 AK kishte publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, ku sipas këtij njoftimi afati i fundit për ofertim ishte data 31.12.2022.

OE "GEO PRIM" SHPK me seli në Tiranë me datën 23.12.2022 kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe me datën 29.12.2022 kishte ushtruar ankesë ke OSHP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 18.11.2022 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE të aprovohet si pjesërisht e bazuar
- Vërtetohet -Njoftimi për kontratë

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me 6 të nenit 108/A dhe në 109 të LPP-së, lidhur me pika 9 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së dhe njëherit duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur sqarimeve të marra nga AK me datën 13.01.2023 për ankesën në fjalë Paneli konstatoi në vijim se:

Përgjigjja e AK-së e datës 13.01.2023, në të cilën AK kishte deklaruar se OE ankues nuk kishte pritur afatin ligjor për përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të datës 23.12.2022, panelin e shtyu të analizojë këtë deklaram të AK-së dhe pas analizimit të provave në e-prokurim dhe si kopje fizike paneli konstatoj se për autoritetin kontraktues akoma nuk kishte kaluar afati ligjor për përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të datës 23.12.2022 ndaj OE ankues sepse paragrafi 6 i nenit 108/A të LPP-së specifikon: Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni.

Duke u bazuar në depozitën e lartcekur paneli vjen në përfundimin se AK afatin e fundit për marrjen e vendimit lidhur me kërkesën e datës 23.12.2022 e kishte datën 29.12.2022 deri në ora 16:00. Sepse OE "GEO PRIM" SHPK me seli në Tiranë, kishte parashtruar kërkesën për rishqyrtim me datën

23.12.2022, e që në rastin konkret data 23.12.2022 i bie dita 0, afati ligjor në pajtim me dispozitën e cekur si më lart për marrjen e vendimit nga ana e AK-së ka filluar nga data 27.12.2022 duke filluar nga ora 08:00 deri në ora 16:00 dhe ky afat ka përfunduar me datën 29.12.2022 ora 16:00 sepse data 24.12.2022 ka qenë ditë e shtunë, data 25.12.2022, ka qenë ditë e diel, ndërsa data 26.12.2022, ka qenë ditë feste .

Nga faktet e prezantuara si më lart paneli konstaton se ankesa e GEO PRIM”SHPK me seli në Tiranë e datës 29.12.2022 (protokoll 809/2022), përveç se është e parakohshme në OSHP e njëjta nuk përmban edhe kushtet për tu shqyrtuar sepse njëjta nuk përmban dëshminë siç kërkohet në pika 9 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së, e njëjta konsiderohet edhe si jo e plotë sepse kjo ankesë nuk e ka të bashkangjitur një kopje të vendimit të miratuar nga autoriteti kontraktues gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A;

- Përfundim -

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe paragrafin 6 të nenit 108/A, 109 dhe nenin 111 të LPP-së dhe përfundimisht konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP- nga OE “GEO PRIM”SHPK me seli në Tiranë (protokoll 809/2022) është e parakohshme dhe jo e plotë, e njëjta nuk shqyrtohet nga bordi por kjo ankese hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi ka Ushtruar këtë ankesë në kundërshtim me nenin 108/A, 109 dhe 111 të LPP-së .

Vendimi si ne piken 3 të këtij vendimi u mos në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së .

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarija e panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë me padi, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t’i dorëzohet;

1x1 AK – Kuvendi Komunal Gjakovë

1x1OE “GEO PRIM”SHPK me seli në Tiranë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së